



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2021

VENDIM
Nr. 234, datë 02.06.2021

PËR
HAPJEN E PROCEDURËS SË TRANSFERIMIT TË PËRKOHSHËM PËR
POZICIONET E LIRA NË GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR KAVAJË

Këshilli i Lartë Gjyqësor mbështetur në nenin 46 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 23, datë 07.02.2019 të KLGJ-së “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit” me ndryshime, duke konstatuar edhe cenimin e rendë të funksionalitetit të gjykatës, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

V E N D O S I:

1. Të shpallë dy pozicione të lira pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë për transferim të përkohshëm deri në një vit.
 2. Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarëve të transferuar, aktualisht në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë znj. Diamela Goxha dhe z. {...}, të cilët të ftohen për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.
 3. Afati për dhënien e pëlqimit të jetë brenda dy ditëve nga njoftimi i këtij vendimi.
 4. Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për ndjekjen e hapave të mëtejshëm të procedurës së transferimit të përkohshëm.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR